



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALËSI E MADHE

KËSHILLI

Nr 1647/Prot.
12

Koplik 26.06.2026

VENDIM

Nr. 34 , Datë 24 . 06 . 2024

Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve të VKB Nr.59, datë 24.12.2025 “Për miratimin e Paketës Fiskale të Bashkisë Malësi e Madhe për vitin 2026”

Këshilli Bashkiak Malësi e Madhe në mbledhjen e datës 24. 06.2026, në bazë të ligjit nr.139/ 2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar; Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006, “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar; Ligjit nr. 9920 dt 19.05.2008 “Për Proçedurat Tatimore në R.SH” i ndryshuar; Ligji nr.115/2014 “Për ndarjen administrative-territoriale të njësisve të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, VKB Nr.59, datë 24.12.2025 “Për miratimin e Paketës Fiskale të Bashkisë Malësi e Madhe për vitin 2026”:

VENDOSI:

1. **Miratimin e kërkesës për disa shtesa dhe ndryshime të VKB Nr.59, datë 24.12.2025 “Për miratimin e Paketës Fiskale të Bashkisë Malësi e Madhe për vitin 2026” si mëposhtë:**
2. **Ne kapitullin I, pika I.2 “Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja”** Në fund të Paragrafit të parë **Baza Ligjore** shtohet Ligji nr. 82/2025 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9632, datë 30.12.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar.
3. Pika I.2 “Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja”, Tabela 6- pika 2 togfjalëshi “si dhe ndërtimeve për qëllime publike” shfuqizohet.
4. Në fund të paragrafit “**Përfundime nga pagimi i taksës**” shtohet pika: “Përfundohen nga pagesa e kësaj takse objektet pronë e paluajtshme e shtetit dhe të destinuara për ushtrimin e funksioneve publike, me pronësi publike, të ndërtuara me financime nga buxheti i shtetit, njësitë e vetëqeverisjes vendore apo nga investimet e enteve publike.
5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55 pika 6 të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”,

KRYETAR

Ilir Halaj

SEKRETAR

Emirjan Hasmujaj

Miratuar me 24.06.2026

Vota Pro 19

Vota Kunder 1

Vota Abstenim 3

Zbardhur me datë 26.06.2026





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALËSI E MADHE

Nr. 1647/ Prot.

Koplik 15.06.2026

PROJEKT VENDIM



Nr. _____, Datë 15.06.2024

Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve të VKB Nr.59, datë 24.12.2025 “Për miratimin e Paketës Fiskale të Bashkisë Malësi e Madhe për vitin 2026”

Këshilli Bashkiak Malësi e Madhe në mbledhjen e datës _____.____.2026, në bazë të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar; Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006, “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar; Ligjit nr. 9920 dt 19.05.2008 “Për Proçedurat Tatimore në R.SH” i ndryshuar; Ligji nr.115/2014 “Për ndarjen administrative-territoriale të njësisve të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, VKB Nr.59, datë 24.12.2025 “Për miratimin e Paketës Fiskale të Bashkisë Malësi e Madhe për vitin 2026”:

Kërkojmë nga ana juaj të miratoni kërkesën për disa shtesa dhe ndryshime të VKB Nr.59, datë 24.12.2025 “Për miratimin e Paketës Fiskale të Bashkisë Malësi e Madhe për vitin 2026” si mëposhtë:

- Ne kapitullin I, pika I.2 “Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja” Në fund të Paragrafit të parë **Baza Ligjore** shtohet Ligji nr. 82/2025 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9632, datë 30.12.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar.
- Pika I.2 “Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja”, Tabela 6- pika 2 togfjalëshi “si dhe ndërtimeve për qëllime publike” shfuqizohet.
- Në fund të paragrafit “Përfundime nga pagimi i taksës” shtohet pika: “Përfundohen nga pagesa e kësaj takse objektet pronë e paluajtshme e shtetit dhe të destinuara për ushtrimin e funksioneve publike, me pronësi publike, të ndërtuara me financime nga buxheti i shtetit, njësitë e vetëqeverisjes vendore apo nga investimet e enteve publike.



RELACION

Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve të VKB Nr.59, datë 24.12.2025 “Për miratimin e Paketës Fiskale të Bashkisë Malësi e Madhe për vitin 2026”.

Na lejoni të ju paraqesim në këtë relacion propozimet e grupit të hartimit të paketës fiskale për disa shtesave dhe ndryshimeve të VKB Nr.59, datë 24.12.2025 “Për miratimin e Paketës Fiskale të Bashkisë Malësi e Madhe për vitin 2026”

Baza për shtesat dhe ndryshimet e VKB Nr. 59, datë 24.12.2025 “Për miratimin e Paketës Fiskale të Bashkisë Malësi e Madhe për vitin 2026”.

- Shkresa nga Drejtoria e Planifikimit Urban, Projekteve, Kadastrës dhe Bujqesisë me nr. 1466 Prot, datë 29.05.2026 “Taksë ndikimi në infrastrukturë- informacion”
- Ligji 82/ 2025 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar.


Në bazë të propozimeve të përmendura. më poshtë paraqiten ndryshimet e sugjeruara për VKB Nr. 59, datë 24.12.2025 “Për miratimin e Paketës Fiskale të Bashkisë Malësi e Madhe për vitin 2026”.

Ne kapitullin I, pika I.2 “Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja”

Në fund të Paragrafit të parë **Baza Ligjore** shtohet Ligji nr. 82/2025 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9632, datë 30.12.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar.

Te pika 2 e Tabeles 6, togfjalëshi “si dhe ndërtimeve për qëllime publike” shfuqizohet

Shtohet në fund të paragrafit *Përfshirje nga pagimi i taksës* pika “Përfshihen nga pagesa e kësaj takse objektet pronë e paluajtshme e shtetit dhe të destinuara për ushtrimin e funksioneve publike, me pronësi publike, të ndërtuara me financime nga buxheti i shtetit, njësitë e vetëqeverisjes vendore apo nga investimet e enteve publike.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALËSI E MADHE

Nr. 1647 Prot.

Koplik, më 15 . 06 .2026

Lënda: Kërkesa për disa shtesa dhe ndryshime në VKB Nr.59, datë 24.12.2025 "Për miratimin e Paketës Fiskale të Bashkisë Malësi e Madhe për vitin 2026"


KËSHILLIT BASHKIAK


Malësi e Madhe

Në bazë të ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar; Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006, "Për Sistemin e Taksave Vendore", i ndryshuar; Ligjit nr. 9920 dt 19.05.2008 "Për Proçedurat Tatimore në R.SH" i ndryshuar; Ligji nr.115/2014 "Për ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", VKB Nr.59, datë 24.12.2025 "Për miratimin e Paketës Fiskale të Bashkisë Malësi e Madhe për vitin 2026":

Kërkojmë nga ana juaj të miratoni kërkesën për disa shtesa dhe ndryshime të VKB Nr.59, datë 24.12.2025 "Për miratimin e Paketës Fiskale të Bashkisë Malësi e Madhe për vitin 2026".

Bashkëngjitur kësaj kërkesë gjeni Projekt- Vendimin dhe Relacionin për miratimin për disa shtesa dhe ndryshime të VKB Nr. 59, datë 24.12.2025 "Për miratimin e Paketës Fiskale të Bashkisë Malësi e Madhe për vitin 2026".



KRYETAR

TONIN MARINAJ